

KIC, 03.09.1998, FDH-29549; *Five Villages of Rahovec Attacked by Sebs Troops Today Morning*, pasqyra e lajmeve, KIC, 03.09.1998, FDH-29549; *Serb Forces Continue Destroying Torching Albanian Settlement in Rahovac Municipality*, pasqyra e lajmeve, KIC, 05.009.1998, FDH-29551; *Serb Forces Kill at Least 11 Albanians in Two Villages of Rahovec Friday*, pasqyra e lajmeve, KIC, 06.09.1998, FDH-29552.

Mark (Zef) Sopiani

(26.04.1950, shqiptar nga Dobërdolli/Dobri dol, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Mark Sopiani ka jetuar në fshatin **Dobërdoll/Dobri dol** me bashkëshorten Lizen, të bijën Elberinen, të birin Eduardin dhe të rejën Katarinen. Djali i tij i dytë jetonte jashtë vendit. Marku aderoi në UÇK më 12.05.1998. Të shumtën e kohës e kalonte në fshat me familjen e vet. Familja e Markut e ka braktisur fshatin më 2.09.1998. U strehua në Doblbarë/Doblbare [Gjakovë/Đakovica]. Marku ndenji në shtëpi. Me një grup të vogël banorësh të fshatit, ai qëndronte fshehurazi në një arë kallamboqi, afër lumit *Drini i Bardhë/Beli Drim*. Në datën **4.09.1998**, rreth orës 13:00, Marku ishte në shoqëri të komshinjve Mehilit dhe Frrokut, në arën e Ejup Sopianit. E kishin ndez zjarrin dhe po i piqnin misra. Marku ishte në rroba civile dhe pa armë, sepse më herët e ka përfunduar ndërresën e vet për atë ditë dhe i kishte dorëzuar armët. Ndenjjen e tyre e ndërpreu një autobлиндë e forcave serbe, nga e cila ushtarët serbë hapën zjarr drejt tre shqiptarëve. Markun e qëlluan në gjoks, ndërsa Mehili dhe Froku arritën që të arratiseshin dhe të shpëtonin nga plumbat. Tri ditë më vonë, djali i Markut, Eduardi, djali i Mehilit, Ndreci, me një kushëri e gjetën trupin e pajetë të Markut. Po atë ditë, e varrosën në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata M.G, FDH-12565; deklarata E.S, FDH-35277; SHFDUÇK, *Feniksët...12*, 164-166; *Bodies of Killed Albanians Scattered about in Rahovec Villages*, pasqyra e lajmeve, KIC, 10.09.1998, FDH-29556; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Adem (Haxhi) Berisha

(1913, shqiptar nga Polluzhë/Poluža, komuna e Rahovecit/Orahovac, një fëmijë)

Në datën **4.09.1998**, forcat serbe së pari e bombarduan **Polluzhën/Poluža** nga drejtimi i fshatit Çiflak/Čiflak. Më pas, hyrën në fshat. Familjarët e Ademit të moshëthyer, së bashku me banorët të tjerë, e braktisën fshatin, por Ademi ndenji në shtëpi. Pas dy ditësh, djali i Ademit, Muharremi, u kthye natën në fshat. Në oborr, e gjeti trupin e pajetë të të atit. Ishte i ekzekutuar me një plumb në kokë. Në mbremjen e datës 7.09.1998, Muharremi e ka varrosur të atin buzë përroskës, pranë shkollës së fshatit. Ademi ende prehet në të njëjtin vend.

Burimet: deklarata M.B, FDH-12208; deklarata I.D, FDH-12209; deklarata S.D, FDH-12210.

Shani (Muharrem) Hoti

(23.11.1954, shqiptar nga Polluzhë/Poluža, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, gjashtë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Shaniu u bë pjesëtar i UÇK-së menjëherë pas sulmit të forcave serbe mbi fshatin fqinj të Saroshit/Saroš. Disa ditë më vonë, ai u emërua komandant i njësitit të UÇK-së në fshat. Në katin e sipërm të shtëpisë së familjes Hoti funksiononte ambulanca. Në datën **4.09.1998**, nga ora 18:00, Shaniu shkoi në pyll për ta vizituar familjen e vet, e cila e braktisi fshatin së bashku me të gjithë banorët e tjerë. Pas pak, u kthye në fshat. Gjeti vdekjen në mbremjen e së njëjtës ditë, rreth orës 19:30, kur ra në pusi të forcave serbe në oborin e doktorit Fadil Bajraktarit [**Polluzhë/Poluža**]. Ditën tjetër, rreh orës 17:00, kur forcat serbe u tërhoqën nga fshati, ushtarët e bartën trupin e Shaniut në shitoren e fshatit. Në datën 6.09.1998, rreth orës 11:00, Shaniu u varros së bashku me pjesëtarin e UÇK-së, Afrim Bajraktari [regjistrimi në faqen vijuese], në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata M.B, FDH-12208; deklarata I.D, FDH-12209; deklarata S.D, FDH-12210; deklarata L.H, FDH-35281; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; *Serb Forces Kill at Least 11 Albanians in Two Villages of Rahovec Friday*, pasqyra e lajmeve, KIC, 06.09.1998, FDH-29552.